



Pranuar / Dorezuar Priljenor/Prodato Received/Delivory	20-02-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	1878/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1247/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1247/2022 të datës 22.12.2022, të parashtruar nga ankuesit Skender Ahmeti të cilin me autorizim e përfaqëson

me adresë rruga kundër Vendimit me Nr. Ref:66/2022 të datës 14.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1247/2022 e datës 22.12.2022 e parashtruar nga ankuesi lidhur me pretendimin për kompensim material.

II. Ndryshohet pjesërisht Vendimi me Nr.Ref:66/2022 i datës 14.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, lidhur me të e drejtën e kompensimit të pagës në pozitën "Inspektor i Operimeve për Helikopter".

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagës për ankuesin, në pozitën "Inspektor i Operimeve për Helikopter", nga lëshimi i kredencialeve të datës 19.12.2018 deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, në pozitën "Zyrtarë i Operimeve për Helikopter", në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve sipas Akt emërimit të datës 01.01.2013 i nënshkruar me datën 31.12.2012, më datën 04.06.2021 ka bërë kërkesë me numër protokoll 2021/DSF/97, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, pasi që ka përmbushë kërkesën e Manualit të Trajnimeve dhe Kredencialet për Inspektor, të lëshuar me 19.12.2018 nga ana e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

Me datë 07.06.2021 ankuesi ka pranuar përgjigjen me numër protokoll 2021/ZDF/181 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa kundër kësaj përgjigje ankuesi me datë 07.06.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2912/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendime ankimor që ti lëshohet Akt emërimi për pozitën "Inspektor të Sigurisë së Fluturimeve" dhe kompensimin e pagës për këtë pozitë nga data 19.12.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.06.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës. Me datën 16.06.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 21.07.2021, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër Anr.1890/2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit, duke anuluar njoftimin të datës 21.07.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 07.06.2021 me numër protokoll 2912/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.11.2022 ka nxjerr Vendimin Anr.506/2022 përmes të cilit ka detyruar Drejtorin të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 04.06.2021 me numër protokoll 2021/DSF/180.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës më datë 14.12.2022 ka nxjerr Vendimin me numër Ref:66/2022 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit, ndërsa ankuesi kundër këtij vendimi më datë 22.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 8299/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që ankuesit ti lëshohet ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit nga pozita "Zyrtar i Operimeve për

*Helikopter*”, në pozitë *”Inspektor i Operimeve Ajrore-Helikopter”*, dhe kompensimin e diferencës së pagës në mes të dy pozitave nga data 19.12.2018, kur të njëjtit i janë lëshuar kredencialet e Inspektorit deri në zbatimin e këtij vendimi duke llogaritur dhe kamatën prej 8%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka proceduar kërkesën e datës 13.01.2023 me numër protokollit 301/2023 për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa me datë 24.01.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kryetari i Këshillit më datë 06.02.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 1462/2023 me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 8299/2022 të datës 22.12.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me prove shtesë të datës 17.01.2023, të bashkangjitur kartelën e kredencialeve të ankuesit për vitin 2023, nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit, Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me numër ref:66/2022 i datës 14.12.2022; Vendimi A.nr 24/2021 i datës 01.03.2021 i Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, KPMSHCK-së; Formulari i vlerësimit për inspektor i datës 12.12.2018; Formulari i vlerësimit për inspektor i datës 15.01.2020; Delegimi i Inspektorit –Inspektor i Operimeve për Helikopter, për ankuesin i datës 19.12.2018; Raporti i punës i datës 13.06.2023 për ankuesin; Lista e trajnimeve e datës 01.01.2013 për ankuesin;/;Vazhdimi i kartelës së kredencialeve të Inspektorit për ankuesin i datës 20.01.2020 bashkangjitur kartela ID nga data 01.02.2020 deri me datë 31.01.2022; Vendimi Nr.Ref:32/2021 i datës 08.11.2021 për zëvendësim të ankuesit; Vendimi Nr. Ref:66/2022 i datës 14.12.2022 për refuzimin e kërkesës së datës 07.06.2022 të ankuesit; Përgjigjen e datës 24.01.2023 në ankesë të ankuesit nga Njësia e personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me nr. Protokollit746/2023;Akt emërimi i datës 31.12.2012, sipas Vendimit Nr.ref:29/20212 e datës 27.11.2012, me përshkrim të detyrave të punës të datës 25.09.2012 dhe ID-kartela e ankuesit me nr.AACK-28; Ri lëshimi i kartelës me kredenciale e datës 12.01.2023 për ankuesin; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtuese i Mesëm , i Ultë dhe Profesional, i datës 18.01.2022; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtuese i Mesëm , i Ultë dhe Profesional, i datës 18.01.2021; Plani i trajnimeve për vitin 2021 i datës 17.12.2020, prej 1/7 faqe; Përshkrim të detyrave të punës të datës 19.12.2018; Vendimi Nr. Ref:31/2022 i datës 22.06.2022 për tërheqjen e kredencialeve për nëpunësit civil të AACK-së; Kërkesë e datës 22.03.2021e ankuesit për çështjen e delegimit të detyrave dhe përgjegjësi; Njoftim me nr. Protokollit 2021/ZDP/143 e datës 26.04.2021; Vendimin me Nr. Port: 1462/2023 të datës 06.02.2023 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ne bazë të provave të lëndës konstaton se ankesa e ankuesit është pjesërisht e *bazuar sepse:*

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton faktin se sipas shkresës Ref. File: AACK/ADM/BNJ-28 të datës 19.12.2018 të lëshuar nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të njëjtit i janë deleguar kompetencat e Inspektorit të Operimeve për Helikopter, duke ju lëshuar edhe kredencialet përkatëse për ushtrimin e kësaj pozite respektivisht edhe i është lëshuar dhe ID-kartela, më pas i është bërë vazhdimi i kredencialeve me datë 20.01.2020 dhe po ashtu së fundmi dhe ID-kartela me datës 12.01.2023 për vitin 2023, ku janë përfshirë dhe përgjegjësit, si në vijim: "...ai/ajo mundet pa ndonjë autorizim apo kufizim të posaçëm, të hyjë dhe inspektoj çdo mjet ajror objektet (pajisjet) të aviacionit civil në Kosovë dhe të inspektoj personelin e aviacionit. Bartësi i kësaj kartele ka të drejtë të ndalojë operimin e njetit ajror, objektit (pajisjes) apo personelit të inspektuar të aviacionit". Atëherë Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh që ankuesi është duke e ushtruar detyrën e pozitës "*Inspektor i Operimeve-Ajrore për Helikopter*", në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve, sipas përshkrimit të detyrave të punës me gradë AACK-3 e cila gradë është me pagë më të lartë se sa pozitën që ankuesi është duke marrë pagën sipas Akt emërimit të datës 31.12.2012 me gradën AAC-4, për pozitën "*Zyrtar i Operimeve për Helikopter*", rrjedhimisht sipas Kolegjit të Këshillit, të njëjtit i takon edhe paga për pozitën që ushtron, sepse i njëjti këtë pozitë është duke e ushtruar nga data 19.12.2018, ku çështje e kredencialeve është vërtetuar edhe me Vendimin A.nr.636/2022 të datës 16.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "*Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*", si rrjedhojë meqë ankuesi ushtron pozitën "*Inspektor i Operimeve-Ajrore për Helikopter*", në bazë të provave të lartcekura, duke ju referuar dispozitave ligjore në fuqi të njëjtit i është dashur të bëhet edhe kompensimi i pagës për pozitën që ushtron bazuar edhe në nenin 3 dhe 9 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit A.nr.506/2021 të datës 25.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është obliguar Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të datës 04.06.2021 lidhur me pretendimin për ndryshim dhe plotësim të akt emërimit nga pozita "*Zyrtar i Operimeve për Helikopter*", në pozitë "*Inspektor i Operimeve Ajrore-Helikopter*", dhe kompensimin e diferencës së pagës në mes të dy pozitave nga data 19.12.2018, mirëpo Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 14.12.2022 ka nxjerrë Vendimin me Nr. Ref: 66/2022 me të cilin nuk i është njohur e drejta për kompensim, atëherë Kolegji i Këshillit, vlerëson se Vendimi me Nr.Ref: 66/2022 i datës 14.12.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për pjesën e refuzimit të kompensimit të diferencës së pagës është i paligjshëm.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura nga palët në procedurë, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër: A.nr.1247/2022

Avdyll BEKTESHI

*Bekteshi*  
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

*Malsore Gashi Bajraktari*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.